



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1597 Prot.

Tiranë, më 24.06.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 34 Datë 24.06 2025

**“PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR KONKURS,
REGJISTRIMIT TË FITUESVE, TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E
TRETË, TË STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH pika 3/ç të nenit 3, nenit 6, pika 28, 29, neni 49, nenit 77, 78, 79, VKM të nr. 112 datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociur" dhe "Profesor", Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 dhe Udhëzimin nr. 7 datë 31.03.2021 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL ", të Statutit të UST, në Rregulloren e Studimit të "Doktoratës" në UST, në zbatim të Urdhërave të MAS nr. 95 datë 25.02.2022 dhe nr. 98 datë 25.02.2022 "Për organizimin e programeve të Ciklit të Tretë Doktoratë në 'Shkencat Sportive' dhe 'Aktivitet fizik dhe Shëndeti', shkresën nr. 397/2 datë 28.03.2015 "Kërkesë për miratimin e kuotave të Ciklit të tretë të studimeve për vitin akademik 2024-2025 në UST", në vijim të shkresës nr. 2101/1 datë 17.06.2025 "Kthim përgjigje" protokolluar në UST me nr. 397/3 datë 19.06.2025, të Vendimit të Senatit Akademik nr.76 datë 24.06.2025, Relacionit nr 1588 prot , datë 23.06.2024, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 24.06.2025:

V E N D O S I :

1. Miratimin e tarifës së aplikimit për aplikantët (FSHL, FVFR) dhe tarifës së regjistrimit të fituesve (FSHL, FVFR) për ciklin e tretë të studimit Doktoratë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2024-2025, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Miratimin e tarifës së shkollimit për studentët që do të ndjekin studimet në ciklin e tretë të studimit doktoratë për të dy fakultetet sipas tabelës bashkëngjitur.
3. Tarifa e shkollimit për ciklin e tretë të paguhet me këste.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, FSHL, FVFR, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI



Nr	FAKULTETI	Emërtimi	Tarifa në lekë
1	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit Cikli i tretë i studimeve)	5,000
2	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES	Tarifa e regjistrimit të kandidatëve(në programet e ciklit të tretë të studimeve	2,000

Nr	FAKULTETI	Emërtimi	Tarifa në lekë
1	FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT	Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit Cikli i tretë i studimeve)	5,000
2	FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT	Tarifa e regjistrimit të kandidatëve(në programet e ciklit të tretë të studimeve	2,000

FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

Tab. 1

Emertimi I Programit cikli I trete te studimeve Doktorate	Tarifa e shkollimit (per kandidatet nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit per te tjere, ne leke
Shkenca Sportive (FSHL	400 000	800 000

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

Tab.2

Emertimi I Programit cikli I trete te studimeve Doktorate	Tarifa e shkollimit (per kandidatet nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit per te tjere, ne leke
Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	400 000	800 000